

VENDIM
Nr.641, datë 3.10.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, 14 e 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përbërja e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, për të gjitha kategoritë e nëpunësve të administratës doganore, ndryshohet, si më poshtë:

- | | |
|--|-----------|
| “- Zëvendësministri i Financave, | kryetar; |
| - Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike
në Ministrinë e Financave, | anëtar; |
| - Zëvendës drejtori i Përgjithshëm Administrativ në
Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - Drejtori i personelit dhe shërbimeve mbështetëse në
Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - Një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar.”. |

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha